

VENDIM
Nr. 145, datë 6.6.2022

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA,
ME NR. 372, SERIA F12/17 NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 106, DATË
20.7.2012, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, neneve 13 dhe 16, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771/2-1 prot., datë 6.6.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Kurum International’ sh.a., me nr. 372, seria F12/17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.7.2012, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 91, datë 28.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 372, seria F12/17, të shoqërisë “Kurum International” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE, me shkresën nr. 70/14 prot., datë 28.4.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.5.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 404/2 prot., datë 5.5.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.

- Shoqëria “Kurum International” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 404/3 prot., datë 13.5.2022, ka paraqitur dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike bazuar në aneksin A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Shoqëria “Kurum International” sh.a. është mbajtëse e licencës nr. 372, seria F12/17, në veprimtarinë së furnizimit të energjisë elektrike që prej datës 20.7.2012, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 106, i ndryshuar së fundi me vendimin 87, datë 7.6.2017 me afat vlefshmërie deri në datën 7.6.2022.

- Neni 16, pika 1, e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcakton se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

Sa më sipër, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 5.4.2022, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1.

- Shoqëria “Kurum International” sh.a. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin

juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e aplikimit si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, germet “a”, “b”, “c”.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germet “a”, “b”, “c”, “d”.
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë furnizimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, germet “a”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 372, seria F12/17, të shoqërisë “Kurum International” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 106, datë 20.7.2012, i ndryshuar për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 8.6.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti